



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:022978

Datë: 02.09.2024

Numri i dokumentit: 06203551

KA.nr.936/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike” ShA, me seli në bulevardin Bill Klinton nr.5 në Prishtinë, kundër të paditurit Zyrës së Rregullatorit për Energji me seli në rrugën Dervish Rozhaja, nr.12 në Prishtinë, dhe personi i interesuar I.M. me vendbanim në rrugën ... nr. ... në Mitrovicë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 22.07.2024 në të cilën morën pjesë të gjitha palët, më 2 shtator 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike” ShA kundër të paditurit Zyrës së Rregullatorit për Energji, me të cilën ka kërkuar anulimin e aktit administrativ V_1218_2019 të datës 27.12.2019 të Bordit të së paditurit.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 14.02.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të Paditurit, me kërkesë për anulimin e aktit administrativ V_1218_2019 të datës 27.12.2019 të Bordit të së Paditurit.
2. Ai në padi por edhe gjatë seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes ka pretenduar se, vendimi i kontestuar është i pabazuar dhe jo i ligjshëm. Sipas tij, faturimi i shërbimeve i datës 08.03.2017 në vlerë prej 118 euro është konform metodologjisë së taksave për kyçje dhe në përputhje të plotë me metodologjinë tarifore të miratuar nga ZRRE. Në këtë drejtim ka shtuar se, konsumatori (Personi i Interesuar) kishte kërkuar pëlqim

elektor energjetik (PEE) për 64 banesa dhe 2 lokale, ndërsa Paditësi i kishte lëshuar PEE pëlqimin nr. 11297 të datës 23.10.2014. Më tutje ka shtuar se, konsumatori kishte bërë ndryshimin brenda objektit të tij, të cilat e kishin tejkaluar PEE e dhënë.

3. Sipas Paditësit, me rastin e dhënies së PEE-së çdo herë parashihet fuqia maksimale të njëkahshme (Pmnj), e që në rastin konkret Pmnj ka qenë 433.2 kW. Ka shtuar se, në PEE të lëshuar nga paditësja ndër kushtet e përcaktuara përkatësisht në pikën 5 theksohet se për çdo rritje të fuqisë konsumatori është i obliguar që nga Paditësi të kërkoj PEE shtesë, ndërsa në pikën 6 të PEE së përcaktohet se, në çoftë se kushtet e paraqitura në PEE nuk realizohen brenda 90 ditësh atëherë ky pëlqim nuk vlen.
4. Paditësi gjithashtu ka deklaruar se, konsumatori në fjalë pas disa vitesh kishte bërë ndryshimin duke mos e respektuar PEE-në dhe duke e tejkaluar pëlqimin e dhënë me fuqinë maksimale të cekur si më lartë. Në këtë drejtim ka argumentuar se, çdo ndryshim të projektit konsumatori të dhënë në PEE është e domosdoshme që të kërkoj PEE plotësues, siç përcaktohen në pikën 5 të pëlqimit, ku theksohet se për çdo rritje të fuqisë konsumatori është i obliguar që nga KEDS të kërkoj PEE shtesë, ndërsa më pasi KEDS të analizoj projektin e ri e më pas të vendoset për pëlqim elektor energjetik PEE plotësues dhe për kapacitetin e përgjithshëm të projektit banesor.
5. I ka kundërshtuar pretendimet e paraqitura nga Pala e Interesuar, duke shtuar se se kapacitetet nuk varen nga metrat katrorë, por nga shpenzimet dhe destinimi i lokalit përkatësisht pjesës së ndarë.
6. I padituri në përgjigje e tij në padi dhe gjatë gjithë procedurës e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e Paditësit dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë si të pabazuar. Ka shtuar se vendimi i tij është vendi i drejtë dhe i ligjshëm sepse nga sa mund të shihet në shkresat e lëndës investitori "Ariani" N.I. ka parashtrua kërkesë në KEDS për kyçje në rrjetin eklektik për objektin banesor afarist. Më tutje ka shtuar se, në PEE vihet re që fuqia maksimale e njëkohshme është 433.2kW, për çka edhe investitori e ka paguar faturën sipas PEE-së me të cilën ishte ngarkuar, ndërsa nga shkresat e lëndës ZRRE ka gjetur se kërkesa e konsumatorit I.M. ka të bëjë me një lokal ekzistues, i cili ka qenë në kuadër të projektit fillestar, por që për nevojat e konsumatorit është ndarë në dy pjesë. Sipas të Paditurit, edhe kapaciteti i kërkuar për ndarjen e lokalit nuk është tejkaluar, por është brenda kapacitetit të dhënë në PEE. Për më tepër as KEDS e as KESCO në shkresat e tyre zyrtare nuk e kanë sqaruar faktin nëse kemi të bëjmë me rritje të

kapacitetit nga ajo të cilën e ka paguar investitori. Më tutje ka shtuar se, Paditësi në pretendimet e tij iu referua kërkesës për rritje të kapacitetit, çka në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një kërkesë të tillë, dhe se sipas ZRRE-së nëse kërkesa shtesë e aplikuesit/konsumatorit për ndarje të lokalit është në kuadër të kapaciteti të dhënë me PEE, për çka edhe investitori i ka paguar detyrimet në KEDS, atëherë konsumatori nuk do të duhej të ngarkohej me taksë shtesë për kapacitet, kurse po që se do të konstatohej saktë që kërkesa për lidhje të re e tejkalon kapacitetin e paguar nga aplikuesi, atëherë kjo kërkesë do të duhet të refuzohej dhe pala do të duhej të udhëzohej që të paguaj kapacitet shtesë kur kushtet teknike e lejojnë një gjë të tillë.

7. Përveç kësaj, i Padituri ka theksuar se nuk është kontestuese që të gjithë aplikuesit për kyçje duhet ta paguajnë taksën për kapacitetin e kërkuar, por që në rastin konkret ritheksojmë faktin që nuk kemi rritje të kapacitetit, për shkak se kapaciteti veçse është paguar nga investitorët.
8. Për fund ka deklaruar se, Paditësi nuk e ka sqaruar mjaftueshëm nëse është fjala për kapacitet shtesë, në të kundërtën për çdo kërkesë për kyçje Paditësi është i obliguar që ta realizoj të njëjtën kur kushtet teknike e lejojnë një gjë të tillë, në të kundërtën konsumatori udhëzohet që të aplikoj për revidim të PEE-së.
9. Personi i Interesuar nuk ka paraqitur fare përgjigje në padi, ndonëse nga gjykata e kishte pranuar aktvendimin përkatës. Megjithatë, në seancën e shqyrtimit kryesor mori pjesë dhe deklaroi se, si pronar i tokës nga investuesi i objektit sipas marrëveshjes i ka marr 600m² lokale, të cilat janë të përfshira në PEE të vitit 2014. Më tutje ka shtuar se, më vonë ka pasur nevojë që lokalit prej 600 m² ta ndaj në njësi, ashtu që për secilin njësi të kem nga një njehsor eklektik. Në lidhje me këtë, me rastin e kyçjes së njehsorit të ri elektrik nuk është rritur kapaciteti pasi hapësira ka mbetur e njëjtë, pra 600m² në tërësi. Sipas tij, tarifat janë të përcaktuara me metodologjinë e taksave të kyçjes dhe në këtë rast kemi të bëjmë me kyçje të njehsorit për të cilin duhet paguar rreth 50 euro siç ka vendosur ZRRE. Për fund ka deklaruar se, nuk qëndron fakti se kapaciteti nuk përcaktohet nga sipërfaqja por nga shpenzimet, sepse nuk është njëjtë sikur të ngrohet një sipërfaqe prej 600 m², sikur një sipërfaqe tjetër me 50 m², ndërsa ai edhe më tutje duhet ta ngroh sipërfaqen prej 600 m² pavarësisht që lokali është ndarë në disa pjesë.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

10. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: vendimi V_1218_2019 i datës 27.12.2019 i të paditurës; vendimi ZRRE/DMK_V_1998_11_19 i datës 18.11.2019 i të paditurës; korrigjimi i shërbimeve të lidhjes së re për njehsorin 67240683 i datës 31.01.2020 në emër të personit të interesuar; pëlqimi elektro energjetik me numër të lëndës 324/2014 i datës 20.10.2014 në emër të “Ariani” NN-N.I., me nr. prot te paditësi 11297 të datës 23.10.2014; dokumenti i titulluar zgjidhja teknike në emër të N.I. pa datë dhe numër; dokumenti i titulluar dalja 10kV kabllat 73000001; proces për pranim të instalimit elektrik me nr. serik 0095626 të datës 02.03.2017 lëshuar nga paditësi për personin e interesuar; rrjedha e njësorit të energjisë aktive lëshuar nga paditësi për personin e interesuar për periudhën kohore mars 2017, janar 2020; si dhe transaksionet e konsumatorit lëshuar nga paditësi në emër të personit të interesuar për periudhën kohore 08.03.2017 – 21.01.2020.
11. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
12. KEDS më 20.10.2014 kishte lëshuar Pëlqimin Elektroenergjetik (këtu e tutje PEE) për konsumatorin Ariani NN – N.I. në rrugën Dëshmorët e Kombit në Vushtrri për objektin banesor me 64 banesa dhe 2 lokale. Në atë pëlqim kishte paraparë se fuqia e instaluar në objekt duhet të jetë $S_i=618.85$ kVa, ndërsa fuqia maksimale e njëkohshme është $P_{mnj}=433.2$ kW sipas projektit. Në pikën 5 të PEE-së kishte paraparë se për çdo rritje të fuqisë elektrike në objekt, konsumatori është i obliguar që nga KEDS, të kërkojë PEE plotësues, si dhe nëse kushtet e parapare me pëlqim nuk realizohen brenda 90 ditëve, atëherë ai pëlqim nuk vlen. Në pikën e fundit të PEE-së ishte përcaktuar se konsumatori duhet të paguaj shumën prej 6498€ për fuqinë e angazhuar, 180€ për shërbimet e kycjes dhe 1068.48€ për TVSh-në. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes PEE-së së cekur në këtë paragraf, ndërsa nuk ishte kontestuese ndërmjet palëve se investitori Ariani NN – N.I. e kishte paguar shumën e ngarkuar me PEE.
13. Punëtorët e KEDS-it më 02.03.2017 e kanë bërë pranimin e instalimit elektrik të njësorit me numër 67240683 me TU: 00.00 dhe TN:00.00 te Personi i Interesuar, përmes kycje

tokësore sipas projektit dhe ormanit. Gjatë atij procesi, Padiësi kishte konstatuar se me rastin e instalimit të njësorit të ri ka shtim të kapacitetit prej 3kW në raport me atë të përcaktuar me PEE. Në këtë rast, Personi i Interesuar kishte shprehur pakënaqësinë e tij. Këto fakte gjykata i konstatoi përmes procesit për pranimit të instalimit elektrik 0095626 të datës 02.03.2017.

14. Më 14.03.2016 Personi i interesuar ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kërkuar që t'i ri shqyrtohet pagesa e taksës prej 118.00 € pas ndarjes së lokalit, sepse sipas tij pas dhënies së pëlqimit elektroenergjetik të objektit, investitori i ka paguar të gjitha taksat e nevojshme, duke përfshirë taksën për fuqi të angazhuar të lokalit. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes vendimit ZRRE/DMK_V_1998_11_19 të datës 18.11. 2019 të së Paditurit, por këto fakte nuk ishin kontestuese ndërmjet palëve.
15. Me datë 27.03.2017 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke refuzuar ankesën e tij në bazë të pëlqimit elektroenergjetik të datës 20.10.2014, në të cilin është theksuar se pëlqimi është për 64 banesa dhe 2 lokale, dhe se çdo kërkesë tjetër për lidhje të re, konsumatori duhet të ngarkohet me faturën e shërbimeve për lidhje të re, në të cilën do të përfshihet tarifa fikse për lidhje në rrjetin trefazor me vlerë prej 40€, dhe në bazë të procesverbalit për pranimit elektroenergjetik për fuqinë prej 3 kW në vlerë financiare prej 60€, si dhe vlera e TVSh, që në total rezulton vlera prej 118€ për shërbime të lidhjes së re. Edhe këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes vendimit ZRRE/DMK_V_1998_11_19 të datës 18.11. 2019 të së Paditurit, por këto fakte nuk ishin kontestuese ndërmjet palëve.
16. Personi i Interesuar si konsumator më 04.04.2017 ka parashtruar ankesë te i Padituri, duke kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga Padiësi, si dhe ka kërkuar t'i bëhet ri shqyrtimi i ngarkesave dhe taksave për ndarje të instalimit ekzistues, pasi sipas tij bazuar në PEE me nr. 324/2014 të datës 20.10.2014, konkretisht në pikën 9 ishte përcaktuar taksa e fuqisë së angazhuar dhe taksa e shërbimit të kycjeve, të cilat investitori i ka paguar. Këtë fakt gjykata po ashtu e vërtetoi përmes vendimit ZRRE/DMK_V_1998_11_19 të datës 18.11. 2019 të së Paditurit, por këto fakte nuk ishin kontestuese ndërmjet palëve.
17. I Padituri duke vepruar si organ administrativ i shkallës së parë, përmes vendimit ZRRE/DMK_V_1998_11_19 të datës 18.11. 2019 e aprovoi ankesën e Personit të

Interesuar dhe e obligoi Paditësin që Personin e Interesuar ta shkarkoj nga shërbimi në vlerë prej 118€ dhe për atë shërbim ta ngarkoj vetëm me taksën për kyçje në rrjetin trefazor 380 V prej 40€ si dhe TVSh-në, konkretisht shumë totale prej 47.20€.

18. Paditësit më 17.12.2019 ka ushtruar ankesë kundër vendimit të shkallës së parë, të cilën i Padituri përmes vendimit V_1218_2019 të datës 27.12.2019 e ka refuzuar dhe e ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë. Në atë vendim ka arsyetuar se, investitori e ka paguar tërë kapacitetin e kërkuar nga Paditësit në PEE, ndërsa konsumatori lokalin që ka qenë në kuadër të projektit fillestar e ka ndarë në dy pjesë dhe kapaciteti i kërkuar për ndarjen e lokalit është brenda kapacitetit të dhënë në PEE. Përveç kësaj, i Padituri kishte arsyetuar se, ankuesi (këtu Paditësi) nuk kishte theksuar se me kërkesën e konsumatorit I.M. a ka rritje të kapacitetit në raport me atë të paguar nga investitori në vitin 2014 dhe nëse po, atëherë sa është kërkesa për shtesë të kapaciteteve.
19. Gjykata gjithashtu konstaton se Personi i Interesuar e kishte ndarë fizikisht lokalin e tij prej 600m² në lokale me hapësira më të vogla, për të cilët ka bërë kyçje me një sor të ri. Këtë fakt gjykata e vërtetoi nga deklarimi i Personit të Interesuar gjatë seancës, e cila nuk ishte kontestuar nga asnjëra palë.
20. Provat tjera të administruara nga gjykata nuk provuar ndonjë fakt tjerët relevant lidhur me këtë çështje, prandaj gjykata vendosi të mos lëshohet në elaborimin e hollësishëm të tyre.

III. Vlerësimi meritor i rastit

21. Gjykata në rend të parë e shqyrtoi se a ka pasur kompetencë i Padituri për ta dhënë vendimin e goditur dhe gjeti se në bazë të nenit 17 para. 1 nënpara. 1.1 të Ligjit 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë rregullatori harton procedura për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë, përfshirë ankesa nga konsumatorët kundër të licencuarve, në lidhje me shërbimet e ofruara, ndërsa në bazë të nenit 17 të Rregullores për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, Bordi i ZRRE-së është përgjegjës për të vendosur për ankesat ose kontestet që paraqiten pranë tij. Prandaj gjykata erdhi në përfundim se i Padituri ka qenë kompetent për ta dhënë aktin administrativ të goditur. Në këtë drejtim, gjykata vëren se nga Paditësi nuk ishte ngritur asnjë pretendim i kësaj natyre.

22. Përveç kësaj, gjykata vëren se i Padituri ka dhënë arsytim të mjaftueshëm për të gjitha çështjet relevante të rastit, si dhe për të gjitha pretendimet e Paditësit, që i ka paraqitur në kundërshtimin e tij. Kështu, nga arsyetimi i aktit administrativ të goditur janë dhënë arsye për çdo pretendim ankimor të Paditësit, duke elaboruar të gjeturat e të Paditurit, si organ kompetent për të vendosur lidhur me kundërshtimin e Paditësit. Gjykata vëren se Paditësi nuk kishte paraqitur pretendim lidhur me arsyetimin e vendimit të goditur.
23. Gjykata gjithashtu gjen se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike. Në këtë drejtim, gjykata e përkrah qëndrimin e të Paditurit si organ administrativ, se Paditësi në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se janë plotësuar kushtet për ta ngarkuar Personin Interesuar për fuqinë e angazhuar.
24. Konkretisht, Paditësi nuk ka paraqitur prova nga të cilat do të rezultonte se me rastin e lidhjes së njësorit 67240683 për Personin e Interesuar është tejkualuar kapaciteti prej 433.2 kW i lejuar me PEE. Fakti se është bërë pranimi i instalimit të ri elektrik nuk nënkupton domosdoshmërisht se ka shtim të kapacitetit, rrjedhimisht konsumatori duhet të ngarkohet edhe me tarifën për shtimin e kapaciteteve prej 3kW. Gjykata rikujton se, sipas nenit 322 para. 2 të LPK-së, barra e të provuarit i takon Paditësit për të vërtetuar se konstatimet e të Padituri nuk kanë qenë të sakta, përderisa në shkresat e lëndës administrative nuk rrjedh diçka tjetër. Prandaj, për derisa Paditësi nuk ka sjellë prova, nga të cilat rrjedh se fuqia maksimale e njëkohshme prej 433.2kW e lejuar me PEE ishte tejkualuar në momentin e instalimit të njësorit të ri, atëherë gjykata gjeti se gjendja faktike e konstatuar nga i Padituri është e saktë, konkretisht nuk ka pasur shtim të kapaciteteve.
25. Përveç kësaj, gjykata vlerëson se i Padituri në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale administrative. Neni 5 para. 3 nënpara. 5 i Rregullores për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji të vitit 2017 ka përcaktuar se “*Operatori i Sistemit duhet të: bëjë kyçjen në rrjet të çdo aplikuesi nëse kjo kyçje është teknikisht e mundshme sipas kushteve të vendosura në Marrëveshjen për Kyçje, dhe ta ngarkojë me taksat të përcaktuara në pajtim me metodologjinë të përcaktimit të taksave të kyçjes*”, kurse para. 8 të të njëjtit nen ka rregulluar “ *Operatori i Sistemit duhet të: arkëtojë prej shfrytëzuesve të sistemit taksat për shfrytëzim të sistemit*”. Sipas këtyre dispozitave, Paditësi si operatori i sistemit përveç që e ka për obligimin që ta ky konsumatorin në

rrjet, ai për këtë kyçje duhet të argëtoj vetëm shumat në bazë të sistemit të taksave të miratuar nga ZRRE.

26. Meqenëse, Personi i Interesuar përmes kyçjes në rrjet nuk e ka tejkaluar kapacitetin e lejuar fillimisht me PEE, atëherë Paditësi nuk ka pasur të drejtë ta ngarkoj atë edhe me tarifën për fuqinë e angazhuar, rrjedhimisht i Padituri me të drejtë e ka anuluar faturimin në këtë pjesë.
27. Prandaj, meqenëse i Padituri ka qenë kompetent për të nxjerr vendimin e goditur, procedura që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit administrativ të goditur është zbatuar në tërësi sipas rregullave të procedurës administrative, duke qenë se i Padituri ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm për të gjitha çështjet relevante të rastit, duke marrë parasysh se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike, siç është sqaruar edhe në pjesën e gjendjes faktike në këtë arsyetim, gjykata vjen në përfundim se nuk është plotësuar asnjë kusht ligjore nga LPPA dhe LKA për anulimin e aktit administrativ të goditur, rrjedhimisht e refuzoi kërkesëpadinë e Paditësit.
28. Bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të LKA, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.936/22

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.